

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Ap – Kž – 448/2011

9 tetor 2012

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Martti Harsia si kryetar i kolegjit, dhe gjyqtarëve të EULEX-it Anne Kerber dhe Elka Filcheva-Ermenkova dhe gjyqtarëve të Gjykatës Supreme Emine Mustafa dhe Avdi Dinaj si anëtarë të kolegjit, të asistuar nga zyrtarja ligjore e EULEX-it Noora Aarnio si procesmbajtëse,

Në lëndën penale kundër të pandehurve;

- 1) **Xh Th**, i dënuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë për veprat penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike [Neni 229 paragrafët 2 dhe 4 i Kodit Penal të Kosovës (KPK) lidhur me nenin 23 të KPK-së] dhe Krimi i organizuar [Neni 274 paragrafi 3 i KPK-së],
- 2) **A K** i dënuar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë për veprën penale Krimi i organizuar [Neni 274 paragrafi 3 i KPK-së], dhe
- 3) **G I**, i liruar nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë nga të gjitha akuzat.

Pas ankesave të prokurorit special Maarit Loimukoski dhe të të pandehurve Xh Th dhe A K përmes avokatëve të tyre mbrojtës Q M dhe R G si dhe V V,

Kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr 504/2010, të datës 4 korrik 2011.

Pas mbajtjes së seancës publike më 9 tetor 2012, në praninë e prokurores së shtetit Judit Eva Tatrai, e të pandehurve Xh Th dhe A K, e avokatëve mbrojtës Q M dhe R G, V V dhe G E, pas mbajtjes së këshillimit dhe votimit mu në këtë ditë,

Më 10 tetor 2012 shpall këtë:

AKTVENDIM

Xh Th, nuk ka nofkë, emri i të atit **H**, emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës **N A**, vendi i lindjes fshati , Komuna e Prizrenit , i lindur më , Kosovar, biznesmen, , ka fëmijë, ka të kryer shkollën fillore, me gjendje të mirë ekonomike, nuk është i dënuar më parë, në paraburgim prej 27 maj 2010.



A. K., nuk ka nofkë, emri i të atit H., emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës M. G., vendi i lindjes fshati., Komuna e Prizrenit., i lindur më., Kosovar, biznesmen,., ka fëmijë, ka të kryer shkollën fillore, me gjendje të mesme ekonomike, nuk është i dënuar më parë, në paraburgim prej 27 maj 2010.

G. I., nuk ka nofkë, emri i të atit Q., emri dhe mbiemri i vajzërisë i nënës S. E., vendi i lindjes fshati., Komuna e Kukësit, Republika e Shqipërisë, i lindur më., Shqiptar,., ka fëmijë, ka të kryer shkollën fillore, me gjendje të dobët ekonomike, nuk është i dënuar më parë, në paraburgim prej 4 dhjetor 2010 deri 4 korrik 2011,

Ankesat e ushtruara në emër të të pandehurve Xh. Th. A. K. dhe ankesa e prokurorit special kundër aktgjyqimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P.nr 504/2010, të datës 4 korrik 2011, pranohen pjesërisht.

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë anulohet në tërësi dhe lënda kthehet në rigjykim në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë.

Të pandehurit Xh. Th. dhe A. K. duhet të mbahen në paraburgim.

Nuk caktohet paraburgim ndaj të pandehurit G. I.

ARSYETIMI

I. HISTORIA E PROCEDURËS

Më 23 dhjetor 2010 prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) ngriti aktakuzë kundër të pandehurve. Xh. Th. u akuzua për dy pika të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike [Neni 229 paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 i Kodit Penal të Kosovës (KPK) lidhur me nenin 23 të KPK-së] dhe Krimi i organizuar [Neni 274 paragrafët 1, 2 dhe 3 i KPK-së],

A. K u akuzua për veprë penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike [Neni 229 paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 i Kodit Penal të Kosovës (KPK) lidhur me nenin 23 të KPK-së] dhe Krimi i organizuar [Neni 274 paragrafët 1, 2 dhe 3 i KPK-së],

G I u akuzua për veprë penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike [Neni 229 paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 i Kodit Penal të Kosovës (KPK) lidhur me nenin 23 të KPK-së] ose, përndryshe dhënia me dashje e ndihmës në kryerjen e veprës së përmendur penale [Neni 25 i KPK-së], dhe Krimi i organizuar [Neni 274 paragrafët 1 dhe 2 i KPK-së],

Më 24 janar 2011 Gjykata e Qarkut në Prishtinë e konfirmoi këtë aktakuzë.

Shqyrtimi gjyqësor u mbajt më 28, 29, 30 mars 2011, 26, 27, 28 prill 2011, 6, 14, 15, 29 qershor 2011 dhe 1 korrik 2011. Aktgjykimi u shpall më 4 korrik 2011.

Aktgjykimi iu dërgua prokurorit të PSRK-së më 7 shtator 2011. Më 21 shtator 2011 ajo ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut.

Aktgjykimi iu dërgua të pandehurit Xh. Th personalisht në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë më 6 shtator 2011. Më 16 shtator 2011 Avokati Mbrojtës Q M dhe R G ushtroi ankesë të përbashkët kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut.

Aktgjykimi iu dërgua të pandehurit A K personalisht në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë në datë të paspecifikuar në shtator 2011. Më 19 shtator 2011 Avokati Mbrojtës V V ushtroi ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut.

II. ANKESAT

1. Ankesa e Prokurorit Special

Prokurorit Special kërkon që e aktgjykimi të ndryshohet siç përshkruhet në ankesë, ose të anulohet në tërësi dhe lënda të kthehet.

2. Ankesa e Xhëme Thaqit

Avokatët mbrojtës Q M dhe R G propozojnë që Gjykata Supreme ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë duke e liruar të pandehurin Th. Në rast se kjo nuk mund të bëhet, avokatët mbrojtës propozojnë që Gjykata Supreme ta prishë aktgjykimin dhe ta kthejë lëndën në gjykatë të shkallës së parë për rigjykim. Në rastin më pak të favorshëm avokatët mbrojtës propozojnë që Gjykata Supreme ta ndryshojë aktgjykimin duke shqiptuar një dënim me burg më të ulët dhe t'i anulojë dënimet me gjyba.



3. Ankesa e A. K.

Avokati Mbrojtës V. V. që Gjykata Supreme ta anulojë aktgjykimin dhe ta kthejë lëndën në gjykatë të shkallës së parë për rigjykim. Në rast se kjo nuk mund të bëhet, avokatët mbrojtës propozojnë që Gjykata Supreme ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë duke e liruar të pandehurin K.

III. PËRGJIGJET

4. Përgjigja e Xh. Th.

Xh. Th. propozon që Gjykata Supreme ta refuzojë ankesën e Prokurorit Special si të pabazuar.

5. Përgjigja e A. K.

A. K. propozon që Gjykata Supreme ta refuzojë ankesën e Prokurorit Special si të pabazuar.

6. Përgjigja e Gëzim Iseberit

G. I. propozon që ankesa e PSRK-së të refuzohet dhe aktgjykimi të vërtetohet në tërësi.

7. Përgjigja e Prokurorit Special

Prokurori Special propozon që Gjykata Supreme ta refuzojë ankesat e të pandehurve Thaqi dhe Kukaj si të pabazuara dhe mbështet dënimin. Prokurori Special, megjithatë, propozon që aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të ndryshohet sa i përket kohës së kaluar tanimë në paraburgim.

8. Mendimi i Prokurorit të Shtetit

Prokurorja e Shtetit propozon që Gjykata Supreme ta pranojë pjesërisht ankesën e Prokurorit Special.

III. GJETJET E GJYKATËS

A. Lejueshmëria e ankesës

1. Gjykata Supreme gjen se ankesat e të pandehurit Th. dhe të prokurorit të PSRK-së ishin të ushtruara brenda afatit kohor 15 ditësh siç përshkruhet në nenin 398 të KPPK-së dhe prandaj janë me kohë dhe të lejueshme. Ankesat janë të ushtruara nga Avokati Mbrojtës dhe prokurori, pra nga persona të autorizuar.
2. Për t'ia garantuar të pandehurit Kukaj të drejtën e tij për mjet efektiv juridik siç përcaktohet me nenin 398 të KPPK-së kjo ankesë duhet të supozohet si e ushtruar me kohë.
3. Kolegji tani do të vlerësojë secilin argument të ngritur në ankesat e mbrojtës.

B. Shkeljet e pretenduara esenciale të procedurës penale


1. Qartësia e dispozitivit

4. Në përputhje me nenin 396 paragrafin 3 të KPPK-së "*Dispozitivi i aktgjykimit përfshin të dhënat personale të të akuzuarit (neni 233 paragrafi 1 i këtij kodi) dhe vendimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, ose me të cilën lirohet nga akuza për atë veprë apo me të cilin refuzohet aktakuza.*" Paragrafi 4 i këtij neni më tutje specifikon se "*Kur i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshin të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 391 të këtij Kodi, ndërsa kur ai është liruar ... dispozitivi përfshin përshkrimin e veprës penale për të cilën është akuzuar.*"

5. Neni 391 i KPPK-së përcakton, në mes tjerash, se "*Gjykata, në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor shënon: 1) Për cilën veprë shpallet fajtor së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse i ligjit penal; 2) Emërtimin ligjor të veprës penale dhe dispozitat e ligjit penal të zbatuara gjatë marrjes së aktgjykimit; ...*"¹ Gjykata Supreme vëren se termi "veprë penale" duhet të interpretohet si gjendje faktike – një përshkrim i sjelljes së të pandehurit – kurse termi "emërtimi ligjor" ka të bëjë me titullin dhe përshkrimin e kodit penal.

6. Sa i përket pikës 1 K dhe Th. janë shpallur të pafajshëm sepse "*nuk ekzistojnë prova të mjaftueshme për të vërtetuar akuzat përtej dyshimit të arsyeshëm; posaçërisht, nuk ekzistojnë prova të mjaftueshme për llojin dhe sasinë e narkotikëve dhe substancave psikotropike të cilat pretendohet se të pandehurit i kishin në posedim dhe që i kanë*

¹ Shkronjat e theksuara janë bërë nga Gjykata Supreme



shpërndarë.”² Po ashtu, aktgjykimi përmbledh veprat penale të aktakuzës duke theksuar se “Pika 1: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, në përputhje me nenin 229 paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) lidhur me nenin 23 të KPK-së e dënueshme me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet; vepër penale që pretendohet se është kryer mes 24 korrikut 2009 dhe 15 shtatorit 2009 nga A. K. dhe Xh. Th.”³

7. Gjykata Supreme vëren se përshkrimi i veprës penale për të cilën akuzohen është thjesht parafrazim i kodit. Në bazë të këtij përshkrimi është e pamundur të thuhet se për cilat vepra penale të pandehurit janë shpallur të pafajshëm.

8. Lidhur me **pikën 2** Gj. I. ishte shpallur i pafajshëm për shkak se “...nuk ekzistojnë prova të mjaftueshme për të vërtetuar akuzat përtej dyshimit të arsyeshëm; posaçërisht, nuk ekzistojnë prova të mjaftueshme për llojin dhe sasinë e narkotikëve dhe substancave psikotropike të cilat pretendohet se të pandehurit i kishin në posedim dhe që i kanë shpërndarë.”⁴ Po ashtu, aktgjykimi përmbledh veprat penale të aktakuzës duke theksuar se “Pika 2: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, në përputhje me nenin 229 paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) lidhur me nenin 23 të KPK-së e dënueshme me burgim prej tre deri në pesëmbëdhjetë vjet; vepër penale që pretendohet se është kryer mes 4 shtatorit 2009 dhe 6 shtatorit 2009 nga G. I.”⁵

9. Gjykata Supreme vëren se sikur në Pikën 1 përshkrimi i veprës penale për të cilën akuzohen është thjesht parafrazim i kodit. Në bazë të këtij përshkrimi është e pamundur të thuhet se për cilat vepra penale i pandehuri në fjalë shpallet i pafajshëm.

10. Lidhur me **pikën 3** Th. ishte “...shpallur fajtor për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, në kundërshtim me nenin 229 paragrafët 2 dhe 4 të KPK-së, lidhur me nenin 23 të KPK-së, për shkak se Xh. Th. në bashkëkryerje me të tjerët, duke përfshirë por jo vetëm me S. T., G. Gj. A. T. dhe H. T. ka organizuar, ka mbikëqyrur dhe ka drejtuar blerjen e substancave narkotike, më saktë 109 kilogramë kanabis sativa, dhe ka planifikuar importimin e tyre nga Shqipëria në Kosovë me qëllim të shpërndarjes gjetiu në Evropë.”⁶

11. Gjithashtu, aktgjykimi përmbledh veprat e aktakuzës duke theksuar se “Pika 3: Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, sipas nenit 229, paragrafëve 1, 2, 3 dhe 4 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) në lidhje me nenin 2, dhe e dënueshme me burgim prej tre deri në

² Aktgjykim i datës 4 korrik 2011, faqe 2 e versionit në gjuhën angleze

³ Aktgjykim i datës 4 korrik 2011, faqe 1 e versionit në gjuhën angleze

⁴ Aktgjykim i datës 4 korrik 2011, faqe 2 e versionit në gjuhën angleze

⁵ Aktgjykim i datës 4 korrik 2011, faqe 1 e versionit në gjuhën angleze

⁶ Aktgjykim i datës 4 korrik 2011, faqe 2-3 e versionit në gjuhën angleze, shkronjat e theksuara nga Gjykata Supreme

pesëmbëdhjetë vjet; veprë penale e cila gjoja ka ndodhur në mes të 1 tetorit 2009 dhe 15 nëntorit 2009 nga Xh Th ...⁷

12. Gjykata Supreme vëren se sikurse në Pikën 1 përshkrimi i aktit për të cilin është akuzuar është thjesht vetëm një parafrzim i kodit. Duke u bazuar në këtë përshkrim është e pamundur të përcaktohet se cilat janë aktivitetet kriminale për të cilat i pandehuri është shpallur i pafajshëm.

13. Gjykata Supreme gjithashtu vëren se neni i cituar në dispozitiv, respektivisht “*neni 229 paragrafi 2 dhe paragrafi 4 i KPPK-së*”, nuk e parasheh blerjen e narkotikëve. Kriminalizimi i blerjes së narkotikëve është përcaktuar në paragrafin 1 i cili nuk është cituar në dispozitiv si bazë ligjore e përgjegjësisë penale të Th Paragrafi 2 parasheh shpërndarjen, shitjen, transportimin e narkotikëve dhe paragrafi 4 parasheh rrethanat e mëtutjeshme rënduese.

14. Gjykata Supreme më tutje vëren se në aktakuzë theksohet se “*në mes të 1 tetorit 2009 dhe 25 nëntorit 2009, Xh Th në territorin e Kosovës ka kryer veprën penale ... duke marrë pjesë në importimin nga Shqipëria në Kosovë dhe transportimin përmes Kosovës ose eksportimin në Evropën perëndimore, përkatësisht në Zvicër, Holandë, Itali dhe/ose në Gjermani, të një dërgese me së paku 105 kg kanabis sativa si anëtarë i një grupi.*”⁸ Vlen të përmendet se aktakuza nuk e ngarkon Th për asnjë lloj përfshirje në blerjen e narkotikëve.

15. Aktvendimi mbi konfirmimin e aktakuzës thekson se “*Aktakuza e paraqitur pranë gjykatës më 23 dhjetor 2011, është konfirmuar në lidhje me të gjitha pikat dhe të gjithë të pandehurit.*”⁹ Aktvendimi në fjalë nuk e ndryshon aktakuzën.

16. Nuk ekziston asnjë indikacion në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor se Prokurori e ka ndryshuar aktakuzën në cilëndo fazë.

17. Sidoqoftë, në fjalën përfundimtare Prokurori ka theksuar se “*... Prokurori ka paraqitur prova se Xh Th ka organizuar, mbikëqyrur dhe drejtuar blerjen e substancave narkotike nga bashkëpunëtorët në Shqipëri ...*”¹⁰

18. Më tutje, dispozitivi flet për “*planifikimin*” e importimit kurse Th shpallet fajtor për kryerjen e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike.


19. Prandaj, dispozitivi në lidhje me pikën 3 duhet patjetër të konsiderohet si tërësisht e pakuptueshme.

⁷ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqe 1 e versionit në gjuhën angleze

⁸ Aktakuza e datës 20 dhjetor 2010, faqe 6 e versionit në gjuhën angleze, e nënvizuar nga Gjykata Supreme

⁹ Aktvendimi mbi konfirmimin e aktakuzës e datës 24 janar 2011, faqe 1 e versionit në gjuhën angleze

¹⁰ Fjala përfundimtare e Prokurorit, faqe 16 e versionit në gjuhën angleze



20. Lidhur me **pikën 4** Th. ishte "... shpallur fajtor për veprën penale të krimit të organizuar në kundërshtim me nenin 274, par. 3 të KPK-së, ... për shkak se në mes të datave 24 korrik dhe 30 nëntor 2009, Xh. Th. dhe A. K. kanë marrë pjesë në një grup aktiv dhe të strukturuar të krimit të organizuar të përbërë nga tre apo më shumë persona qëllimi i të cilëve ishte transportimi, shpërndarja dhe ofrimi substancave narkotike me qëllim të shpërndarjes së tyre, shitjes ose ofrimit të tyre në shitje. Xh. Th. ka organizuar, ka mbikëqyrur dhe ka drejtuar aktivitetet e grupit të krimit të organizuar duke aranzhuar dhe bashkërenditur importimin, dërgesën dhe financimin e dërgesave të substancave të kontrolluara."¹¹

21. Gjykata Supreme vëren se përshkrimi i veprës me të cilën është ngarkuar në pikën 1 të aktakuzës është thjesht vetëm një parafrazim i kodit. Duke u bazuar në këtë përshkrim është e pamundur të përcaktohet se cilat janë aktivitetet kriminale për të cilat shpallet fajtor i pandehuri në fjalë.

22. Më tepër, Gjykata Supreme konstaton se kryerja e të ashtuquajturit "krimit bazë", si krim i rëndë, është parakusht që një vepër të përbëjë vepër penale të krimit të organizuar sipas nenit 274, par. 1 të KPK-së. Për këtë arsye, përgjegjësia për veprën penale të krimit të organizuar nuk mund të konstatohet pa u konstatuar së pari përgjegjësia penale për veprën e rëndë penale.

23. Gjykata Supreme përkujton se Gjykata e Qarkut ka shpallur Th. të pafajshëm për krimin bazë në pikën 1 të aktakuzës – blerje, posedim, shpërndarje dhe shitje e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike, në mes të datave 24 korrik 2009 dhe 15 shtator 2009 – për shkak të provave të pamjaftueshme. Megjithatë, Gjykata Supreme ka shpallur Th. fajtor për pikën 4 të krimit të organizuar, po ashtu edhe për periudhën e përmendur kohore për të cilën i njëjti ishte shfajësuar përkitazi me "krimin bazë". Për më tepër, dispozitivi nuk e përshkruan asnjë sjellje tjetër të Th. e cila do të përbënte krim të rëndë – "krimin bazë" gjatë periudhës kohore ndërmjet datave 24 korrik 2009 dhe 15 shtator 2009. Për këtë arsye, dispozitivi në fjalë është në kundërshtim me vetveten.

24. Lidhur me **pikën 4** K. ishte "... shpallur fajtor për veprën penale të krimit të organizuar në kundërshtim me nenin 274, par. 2 të KPK-së, për shkak se në mes të datave 24 korrik dhe 30 nëntor 2009, Xh. Th. dhe A. K. kanë marrë pjesë në një grup aktiv dhe të strukturuar të krimit të organizuar të përbërë nga tre apo më shumë persona qëllimi i të cilëve ishte transportimi, shpërndarja dhe ofrimi substancave narkotike me qëllim të shpërndarjes së tyre, shitjes ose ofrimit të tyre në shitje. ... A. K. në mënyrë aktive ka marrë pjesë në grupin e krimit të organizuar, duke kryer mes tjerash caktimin e korrierëve për transportimin e substancave të kontrolluara, duke e ditur se me pjesëmarrjen e vet i njëjti do të kontribuonte në kryerjen e krimeve të rënda nga ana e grupit të organizuar kriminal."

¹¹ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqja 3 e versionit në gjuhën angleze

25. Gjykata Supreme vëren se përshkrimi i veprës me të cilën është ngarkuar në pikën 1 të aktakuzës është thjesht vetëm një parafrazim i kodit. Duke u bazuar në këtë përshkrim është e pamundur të përcaktohet se cilat janë aktivitetet kriminale për të cilat shpallet i pafajshëm i pandehuri në fjalë.

26. Më tepër, Gjykata Supreme lidhur me Th. ... konstaton se Gjykata e Qarkut e ka shpallur të njëjtin të pafajshëm për “krimin bazë” në pikën 1 të aktakuzës për shkak të provave të pamjaftueshme. Por, për dallim nga Th. ..., K. ... nuk është akuzuar për asnjë “krim tjetër bazë”. Për më tepër, Gjykata e Qarkut ka shpallur fajtor K. ... për pikën 4 – krim i organizuar. Megjithatë, dispozitivi nuk e përshkruan asnjë sjellje tjetër të K. ... e cila do të përbënte pjesëmarrje aktive apo të qenit në dijeni që kjo gjë paraqet kontribut në krim të rëndë – “krimin bazë”. Për këtë arsye, dispozitivi në fjalë është në kundërshtim me vetveten.

27. Lidhur me **pikën 5 G**, I. ... ishte shpallur i pafajshëm për shkak se “... ka prova të pamjaftueshme për të dëshmuar përtej dyshimit të arsyeshëm; në mënyrë specifike, kishte prova të pamjaftueshme se i pandehuri ka qenë anëtar i një grupi të organizuar ose ka ditur se po kontribuonte për kryerjen e krimeve të rënda nga ana e grupit të organizuar kriminal.”¹² Po ashtu, aktgjykimi bën përmbledhjen e veprave penale të aktakuzës duke theksuar se “Pika 5: krim i organizuar, sipas nenit 274 të KPK-së, vepër e dënueshme me nga shtatë deri në njëzet vjet burgim; është kryer ndërmjet datave 4 shtator 2009 dhe 6 shtator 2009 nga ana e G. ... I. ...”¹³

28. Gjykata Supreme konstaton se lidhur me pikën 1, përshkrimi i veprës me të cilën ishte ngarkuar i njëjti ishte thjesht vetëm një parafrazim i kodit. Duke u bazuar në një përshkrim të tillë është e pamundur të përcaktohet se cilat janë aktivitetet kriminale për të cilat i pandehuri në fjalë shpallet i pafajshëm.

2. A është i mjaftueshëm arsyetimi?

29. Po ashtu, arsyetimi i aktgjykimit të apeluar është i pamjaftueshëm. Nuk është e qartë se cilat fakte janë shpallur të vërtetuara nga Gjykata e Qarkut. Nuk ekziston përshkrimi faktik i cili do të sqaronte se cilat vepra – d.m.th. sjelljen e tyre e jo cilësimin juridik – janë vërtetuar se janë kryer nga secili i pandehur.

30. Lidhur me **pikën 1** aktgjykimi në fjalë konstaton se “të pandehurit kishin një sërë komunikimesh lidhur me dërgesën e shtatorit ... anëtarët e grupit kriminal kishin këmbyer thirrje telefonike dhe porosi SMS. Në mesin e këtyre komunikimeve të llojllojshme të cilat shpijnë tek e ashtuquajtura dërgesë e shtatorit ka referenca lidhur me dërgimin e narkotikëve në Itali... dhe në Zvicër ...”¹⁴ Aktgjykimi po ashtu përmend se “Grupi në fjalë kishte planifikuar paraprakisht që narkotikët t'i sillte në shtëpinë e Xh. Th. ... në ... dhe pastaj prej aty t'i dërgonte në Zvicër dhe në vendet tjera.”¹⁵ Pastaj ky

¹² Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqja 3 e versionit në gjuhën angleze

¹³ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqja 2 e versionit në gjuhën angleze

¹⁴ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqja 9 e versionit në gjuhën angleze

¹⁵ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqja 14 e versionit në gjuhën angleze



aktgjykim vazhdon duke përshkruar organizimin e transportimit përmes komunikimit dhe takimeve si dhe përmes transportimit nga Th. K., “të një numri të madh personash”, S. T., G. I., “dy personave”, “një personi të ri person” dhe të H. T.¹⁶ Megjithatë, për t’i dhënë fund diskutimit rreth “dërgesës së shtatorit”, në aktgjykimit në fjalë shkruan se “dërgesa e **pohuar** e muajit shtator 2009” dhe “... substancat e **pohuara** të kontrolluara nuk ishin konfiskuar, ndërsa thirrjet e përgjuara telefonike nuk janë mjaft të qarta për të konstatuar natyrën e këtyre substancave. Si rezultat i kësaj, kolegji nuk mund të pandehë as të supozojë se çfarë kishte në pakon e cila **pohohet** të jetë transportuar.”¹⁷

31. Gjykata Supreme vëren se mbetet e paqartë nëse kolegji kishte konstatuar se ishte transportuar diçka por mbetet e paqartë cilësia e asaj substance apo nëse kolegji nuk kishte gjetur prova të mjaftueshme se ishte transportuar ndonjë substancë.

32. Lidhur me **pikën 2** aktgjykimi gjen se “prokuroria pretendon se është provë rrethanore fakti që I. kishte lënë narkotikët në garazhe prej nga i kishte marrë këta narkotikë të nesërmen.” Aktgjykimi nuk tregon nëse Gjykata e Qarkut është pajtuar apo jo me këtë pretendim. Më tej, siç shpjegohet më lart aktgjykimi diskuton komunikimin ndërmjet Th., G. I. dhe “dy personave”.¹⁸ Aktgjykimi pastaj vazhdon duke deklaruar se “... një person i ri mori përsipër detyrën e shoferit të kombit. I. doli nga kombi dhe mbeti në këmbë. ... **besohet** se shoferi i kombit e kuptoi se ishte duke u përcjellë ... dhe se ky shofer hodhi narkotikët në një fushë aty pranë, duke pasur si qëllim t’i merrte më vonë.”²⁰ Konstatimet e Gjykatës së Qarkut janë të përbashkëta me konstatimet e shpjeguara më lart lidhur me pikën 1.

33. Gjykata Supreme konstaton se, sikur tek pika 1, mbetet e paqartë nëse kolegji ka konstatuar se diçka ishte transportuar por mbetet e paqartë cilësia e substancës në fjalë, por nëse kolegji nuk kishte prova të mjaftueshme nëse ishte transportuar ndonjë substancë apo jo. Më pastaj vlen të përmendet se aktgjykimi në fjalë në mënyrë të qartë konstaton se I. nuk ishte duke drejtuar kombin kur, siç pretendohet, narkotikët ishin hedhur jashtë automjetit.

34. Lidhur me pikën 3, aktgjykimi gjen se “duke filluar nga tetori 2009 Xh. Th. kishte organizuar, kishte mbikëqyrë dhe kishte drejtuar blerjen e 109 kilogramëve kanabis sativa nga bashkëpunëtorët e tij në Shqipëri.”²¹

35. Siç thuhet në pikat 13 – 16 më sipër, aktakuza bën fjalë për pjesëmarrje në importimin dhe transportimin e narkotikëve anembanë Kosovës por nuk përmend

¹⁶ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqet 14 – 16 të versionit në gjuhën angleze

¹⁷ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqja 15 e versionit në gjuhën angleze, ndërsa theksimin me vija të trasha e ka bërë Gjykata Supreme

¹⁸ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqja 15 e versionit në gjuhën angleze

¹⁹ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqet 14 – 15 të versionit në gjuhën angleze

²⁰ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqja 15 e versionit në gjuhën angleze, ndërsa theksimin me vija të trasha e ka bërë Gjykata Supreme

²¹ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqja 17 e versionit në gjuhën angleze, ndërsa theksimin me vija të trasha e ka bërë Gjykata Supreme

pjesëmarrjen në blerjen e këtyre narkotikëve. Neni 229, paragrafi 3 flet për transportimin e narkotikëve ndërmjet kufijve shtetërorë duke përcaktuar që “kushdo që pa autorizim eksporton ose importon substanca a preparate të cilat janë shpallur narkotikë të rrezikshëm, ose substanca psikotropike dënohet me ...” Kolegji ka konstatuar se “Th ka planifikuar transportimin e tyre nga Shqipëria për në Kosovë me qëllim të shpërndarjes dhe shitjes së tyre në destinacionet e tjera evropiane. Narkotikët, megjithatë, nuk arritën gjer në Kosovë. ... policia shqiptare ndaloi një automjet Mercedes Benz ... të braktisur nga korrierët ... në të cilën kishte 102 pako... me një peshë të përgjithshme prej 109 kilogramësh ... duke konfirmuar përbërjen e tyre se bëhej fjalë për kanabis sativa.”²² Për këtë arsye, kolegji nuk ka konstatuar se Th bëri transportimin e narkotikëve. Përkundrazi, kolegji shprehimisht kishte thënë se narkotikët në fjalë nuk kaluan asnjë herë kufijtë shtetërorë, dhe se Th vetëm kishte planifikuar që t’i importonte të njëjtit në Kosovë.

36. Th është shpallur fajtor për veprën lidhur me narkotikët në fjalë, duke u bazuar në nenin 229, paragrafin 2 të KPK-së. Gjykata Supreme përkujton se paragrafi në fjalë përcakton që “kushdo që pa autorizim shpërndan, shet, transporton ose dërgon substanca a preparate të cilat janë shpallur të rrezikshme, narkotikë ose substanca psikotrope me qëllim shpërndarjeje, shitjeje ose oferte për shitje dënohet me ...” Aktgjykimi nuk përfshin gjetjen se Th kishte qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me sasinë prej 109 kg të substancës kanabis sativa të sekuestruar nga policia shqiptare më datën 25 nëntor 2009 (të ashtuquajturën “dërgesë të nëntorit”). Aktgjykimi gjithashtu nuk deklaroi shprehimisht se cilat veprime të Th rezultojnë me përgjegjësi penale, në bashkëryerje me të tjerët, për shpërndarjen, shitjen, transportimin apo dërgimin e narkotikëve. Gjykata Supreme konstaton se aktgjykimit i mungon arsyetimi lidhur me faktet materiale.

37. Në arsyetim thuhet se “pas ngjarjeve të shtatorit, Xh Th ... vazhdoi me pjesëmarrjen e vet në këtë grup të krimit të organizuar. Roli i Xh Th ishte që të organizonte, të mbikëqyrte dhe të drejtonte aktivitetet e grupit të organizuar kriminal duke aranzhuar dhe bashkërenditur importimin, dërgimin dhe financimin e dërgesave me substanca të kontrolluara.”²³ Pastaj aktgjykimi vazhdon me sqarimin e mënyrës së komunikimit të Th me personat H. T dhe A. T të cilët jetojnë në Holandë rreth financimit dhe sasisë së këtyre narkotikëve, me A. K rreth financimit dhe me G. Gj rreth sasisë së narkotikëve, rreth datave të dërgimit dhe rreth korrierit. Aktgjykimi po ashtu vëren se Th dhe G. Gj tanimë ishin takuar.²⁴

38. Gjykata Supreme konstaton se pas diskutimit të sqaruar më lart rreth rolit të Th në aranzhimin dhe bashkërendimin e importimit, dërgimit dhe financimit të dërgesave arsyetimi në fjalë në mënyrë të befasishme konstaton se “prokuroria ka vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se Xh Th është fajtor për pikën 3. (dërgesa e

²² Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqja 17 e versionit në gjuhën angleze

²³ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqja 16 e versionit në gjuhën angleze, ndërsa theksimi në vijë të trasha e ka bërë Gjykata Supreme

²⁴ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqet 17 – 18 të versionit në gjuhën angleze



nëntorit)" e cila sipas dispozitivit është organizimi, mbikëqyrja dhe drejtimi i blerjes së narkotikëve. Gjykata Supreme konstaton se një përfundim i këtillë nuk përputhet me nenin e cituar në dispozitiv si dhe me arsyetimin. Për këtë arsye, Gjykata Supreme gjen se arsyetimi është i pamjaftueshëm lidhur me përgjegjësinë e Th për blerjen e narkotikëve.

39. Gjykata Supreme konstaton se dispozitivi po ashtu i referohet nenit 229, paragrafit 4 të KPK-së si bazë e përgjegjësisë penale të Th. Dispozitivi nuk e specifikon shprehimisht se cila nga rrethanat vështirësuese konsiderohet se është përmbushur në këto nëntë pikat e radhitura në paragrafin e përmendur. Dispozitivi nuk përcakton "bashkëkryerjen me të tjerët" por është e paqartë nëse kjo gjë po ashtu interpretohet si "veprim si anëtar i grupit" siç përcaktohet në nenin 229, paragrafin 4, pikën 1 të KPK-së. Po ashtu ky aktgjykim nuk e diskuton raportin ndërmjet përgjegjësisë penale si bashkëkryerës, rrethanën vështirësuese të "veprimet si anëtar i grupit" dhe përgjegjësinë penale duke u bazuar në veprimin si anëtar i grupit të organizuar kriminal.

40. Lidhur me pikat 4 dhe 5, krim i organizuar, aktgjykimi gjen se "komunikimi i përgjuar ndërmjet personave Xh Th, S, T, A, K, H, T, G, Gj, G, L dhe të tjerëve vërteton ekzistimin e grupit kriminal ndërkombëtar të organizuar mirë qëllimi i të cilit është që të importojë dhe të shpërndajë substanca të kontrolluara për një profit substancial për anëtarët e këtij grupi. Thirrjet e përgjuara telefonike janë të mbushura përplot me referenca mbi marrëveshjet financiare, profitet dhe dërgimin e narkotikëve. ... Është e qartë nga tërësia e komunikimeve të përgjuara se të njëjtin po flasin për të njëjtën gjë, dhe atë për krimin e organizuar me fokus të importimit dhe të shpërndarjes së narkotikëve të kundërligjshëm."²⁵ Pastaj në diskutimin e radhës rreth "dërgesës së shtatorit", aktgjykimi e nënvizon arsyetimin dhe konstaton se kjo vepër penale me narkotikë nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm. Aktgjykimi po ashtu thekson se "pas ngjarjeve të shtatorit, Xh Th A K dhe të tjerët vazhduan të marrin pjesë si anëtarë të këtij grupi të organizuar kriminal."²⁶ Pas dhënies së arsyetimit lidhur me "dërgesën e nëntorit", aktgjykimi vazhdon më tej duke thënë "përveç kësaj, prokuroria ka vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se Xh Th dhe A K janë fajtorë për pikën 4, krim i organizuar ..."²⁷

41. Gjykata Supreme konstaton se periudha kohore e kryerjes së veprave të pohuara penale të krimit të organizuar është koha prej 24 korrikut 2009 deri më 30 nëntor 2009, pra kjo periudhë mbulon si "dërgesën e shtatorit" ashtu edhe "dërgesën e nëntorit".

42. Lidhur me "dërgesën e shtatorit" e cila mbulon kohën nga data 24 korrik 2009 deri më 15 shtator 2009, Gjykata Supreme përkujton se si Th ashtu edhe K janë liruar nga vepra penale e blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve, vepër kjo e ashtuquajtur "krim bazë". Aktgjykimi nuk përmban përshkrimin e veprimeve të Th apo të K, mbi të cilat bazohet përgjegjësia penale për veprën

²⁵ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqja 9 e versionit në gjuhën angleze

²⁶ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqja 16 e versionit në gjuhën angleze

²⁷ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqja 18 e versionit në gjuhën angleze

penale të krimit të organizuar në periudhën ndërmjet datave 24 korrik 2009 dhe 15 shtator 2009.

43. Më tej, lidhur me “dërgesën e nëntorit” e cila mbulon periudhën ndërmjet 16 shtatorit dhe 30 nëntorit të vitit 2009, Gjykata Supreme përkujton se dispozitivi konstaton se Th [redacted] ka kryer veprën penale të krimit të organizuar përmes organizimit, mbikëqyrjes dhe drejtimit të aktiviteteve të grupit të organizuar kriminal “*duke aranzhuar dhe bashkërenditur importimin, dërgimin dhe financimin e dërgesave ...*”²⁸ Megjithatë, aktgjykimi në mënyrë të qartë thotë se narkotikët e “dërgesës së nëntorit” ishin braktisur nga anëtarët e grupit dhe ishin zënë nga policia në Shqipëri dhe në këtë mënyrë nuk kishin mundur të importoheshin në Kosovë. Po ashtu, lidhur me pikën 3 aktgjykimi në fjalë shpall Th [redacted] fajtor për “krimin bazë” të organizimit, mbikëqyrjes dhe drejtimit të blerjes së 109 kilogramëve të substancës kanabis sativa, ku “dërgesa e nëntorit”, përkrimi i “krimit bazë” dhe krimi i organizuar nuk përputhen njëri me tjetrin. Për këtë arsye, aktgjykimi nuk përmban përkrimin e veprimeve të Th [redacted] mbi të cilat bazohet vepra penale e krimit të organizuar në mes të datës 16 shtator dhe 30 nëntor 2009.


44. Për më tepër, K [redacted] nuk është akuzuar për pikën 3, për “dërgesën e nëntorit” e cila mbulon periudhën kohore prej datës 16 shtator dhe 30 nëntor 2009. Në arsyetim, K [redacted] përmendet një herë si një person të cilin e thërret Th [redacted] më datën 26 tetor 2009.²⁹ Ky aktgjykim po ashtu vëren se nga shtëpia e K [redacted] ishin konfiskuar 13,000 euro, se i njëjti nuk ka burim ligjor të të ardhurave dhe se sqarimi i tij për këtë shumë të lartë të parave të gatshme në shtëpinë e tij ishte thjesht i pabesueshëm.³⁰ Prandaj, aktgjykimi në fjalë nuk përmban përkrimin e veprimeve të K [redacted] mbi të cilat bazohet përgjegjësia penale për veprën penale të krimit të organizuar në mes të datës 16 shtator dhe 30 nëntor 2009. Për më tepër, arsyetimi nuk e përmend faktin që dëshmitari Sh [redacted] jep një sqarim lidhur me origjinën e parave i cili përputhet me sqarimin e ofruar nga K [redacted] – që Sh [redacted] kishte huazuar këto para nga e dashura e tij dhe pastaj ia kishte dhënë hua K [redacted]. Shkresat e lëndës po ashtu përmbajnë një dëshmi të së dashurës së dëshmitarit Sh [redacted] e cila ka një përmbajtje të ngjashme. Gjykata e Qarkut nuk ka dhënë asnjë arsye lidhur me faktin pse nuk i kishte konsideruar dëshmitë e dhëna nga K [redacted] dhe nga Sh [redacted] si të besueshme. Për këtë arsye, Gjykata Supreme konstaton se këtij aktgjykimi i mungon arsyetimi i vërtetë.

45. Po ashtu, lidhur me L [redacted], siç është theksuar më lart, aktgjykimi në fjalë gjen se komunikimet e përgjuara të zhvilluara ndërmjet personave Th [redacted], K [redacted] dhe I [redacted] vërtetojnë ekzistimin e një grupi kriminal ndërkombëtar të organizuar mirë. Megjithatë, pas ofrimit të arsyetimit lidhur me “dërgesën e shtatorit” dhe pas konstatimit se prokuroria kishte dështuar të vërtetonte elementet e pikës 2 përtej dyshimit të arsyeshëm, aktgjykimi vazhdon duke deklaruar se “Përveç kësaj, prokuroria ka dështuar të vërtetojë elementet e pikës 5, të krimit të organizuar ndaj G [redacted] I [redacted], dhe se i njëjti lirohet nga

²⁸ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqja 3 e versionit në gjuhën angleze, ndërsa theksimin me fjalë të trasha e ka bërë Gjykata Supreme

²⁹ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqja 17 e versionit në gjuhën angleze

³⁰ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqja 18 e versionit në gjuhën angleze



*kjo veprë.*³¹ Pasi që këto dy dëshmi në arsyetim duket se janë në kundërshtim me njëra tjetrën arsyetimi i aktgjykimit del të jetë i paqartë.

46. Në fund, aktgjykimi nuk përmban arsyetim lidhur me arsyen pse gjykata ishte udhëhequr në zgjidhjen e pikave të ligjit, në veçanti, në konstatimin e ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të të akuzuarit, ose në zbatimin e dispozitave specifike të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij – ashtu siç përcaktohet me nenin 396, paragrafin 7 të KPPK-së.

47. Gjykata Supreme konstaton se gjykata e shkallës së parë ka shkelur në mënyrë esenciale dispozitën e procedurës penale.

C. Vërtetimi i gjendjes faktike

48. Gjykata Supreme përsërit edhe një herë se është e drejtë e posaçme e trupit gjykues që të vlerësojë provat e prezantuara edhe kur të njëjtat janë kontradiktore. Kjo ngase Gjykata e Qarkut, pasi ka dëgjuar drejtpërdrejt provat është në pozitën më të mirë për të vlerësuar besueshmërinë e dëshmitarëve dhe / ose të ekspertëve. Është detyrë e Gjykatës Supreme që të përcaktojë nëse gjykata ku është zhvilluar gjykimi ka bërë një vlerësim të tillë si duhet apo jo. Revidimi i Gjykatës Supreme për vlerësimin e Gjykatës së Qarkut prandaj është i kufizuar në ato çështje lidhur me atë nëse faktet janë shtjelluar me kujdes, nëse provat e prezantuara kanë qenë të pranueshme dhe nëse vlerësimi ka qenë i besueshëm, logjik dhe i kuptueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka lirinë e veprimit rreth vlerësimit të provave ndërsa Gjykata Supreme vetëm bën rivlerësimin e provave në qoftë se gjejnë gabime në vlerësimin e gjykatës. Gjykata Supreme vetëm në raste të jashtëzakonshme bën pranimin e provave.

49. Të pandehurit sërish mohojnë se kanë qenë të përfshirë me narkotikë të rrezikshëm ose që kanë formuar grupin e organizuar kriminal. Në këtë mënyrë, të pandehurit nuk pranojnë se kanë kryer veprën penale të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së narkotikëve të rrezikshëm ose të veprës penale të krimit të organizuar.

50. Siç u tha më lart, Gjykata Supreme ka gjetur se përshkrimi faktik nuk është bërë sa duhet në aktgjykim dhe se edhe arsyetimi ka qenë i pamjaftueshëm. Pasi që është e paqartë se çfarë janë gjetjet e Gjykatës së Qarkut dhe mënyra se si Gjykata e Qarkut ka ardhur gjer tek përfundimet e këtylla, Gjykata Supreme nuk është në pozitë që të vlerësojë vlerësimin e provave të prezantuara i cili është kryer nga Gjykata e Qarkut.

D. Shkeljet e pohuara të ligjit penal, konfiskimi dhe dënimi

51. Gjykata Supreme është e mendimit se pasi që lënda në fjalë po kthehet në rigjykim, nuk ka nevojë të deklarohet lidhur me çështjet në fjalë.

³¹ Aktgjykimi i datës 4 korrik 2011, faqja 16 e versionit në gjuhën angleze

E. Paraburgimi

52. Në bazë të nenit 391, para. 1, pikës 5 të KPPK-së “Në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpall fajtor, gjykata e shënon: ... vendimin për llogaritjen e kohës së kaluar në paraburgim ... në lartësinë e dënimit;”

53. Gjykata Supreme konstaton se aktgjykimi i apeluar nuk përfshin vendimin për të llogaritur kohën e kaluar në paraburgim në lartësinë e dënimit të shqiptuar ndaj të pandehurve. Gjykata Supreme vëren se Gjykata e Qarkut duhet ta përfshijë këtë shënim në aktgjykim në rast se rigjykimi përfundon me shqiptim të dënimit.

IV. PËRFUNDIMET

53. Duke u bazuar në të gjitha arsyet e dhëna më sipër, vendoset si në dispozitiv.

Sot më datën 9 tetor 2012.

Ap. - Kž. Nr. 448 / 2011

Kryetari i kolegjit

Martti Harsia

Anëtarja e kolegjit

Anne Kerber

Anëtarja e kolegjit

Emine Mustafa

Procesmbajtësja

Noora Aarnio

Anëtarja e kolegjit

Elka Filcheva-Ermenkova

Anëtari i kolegjit

Punëtori i autorizuar
Ovlaščeni radnik

Avdi Dinaj

